

Gratë dhe Burrat në Shqipëri, 2021

Tiranë, më 6 Korrik 2022: “Gratë dhe Burrat” është publikim vjetor që paraqet të dhëna të ndara sipas gjinisë në fusha të ndryshme të jetës si popullsia, shëndetësia, arsimit, tregu i punës, vendimmarrja etj, të nevojshme për shoqërinë tonë. Publikimi pasqyron edhe ndryshimet kryesore ndër vite të legjislacionit në fushën e barazisë gjinore. Ky publikim nuk përmban analiza të treguesve apo fenomene, por pasqyron situatën korente sipas treguesve matës.

Publikimi i parë daton në vitin 1998. Çdo publikim është shoqëruar me informacione dhe tregues të rinj.

Këtë vit janë përfshirë disa tregues të cilët lidhen me mbojtjen sociale si: punëkërkuar të papunë të regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie, ndihmën ekonomike, si dhe qendrat sociale për të moshuarit. Për më tepër, janë shtuar edhe disa tregues të arsimit sipas programeve të studimit. Publikimi mbyllet me Indeksin e Pabarazisë Gjinore dhe Setin Minimal të Treguesve Gjinorë.

Në botim janë evidentuar disa gjetje kryesore si në vijim:

Popullsia:

- Lindshmëria në adoleshencë është zvogëluar në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2021, janë regjistruar 12,1 lindje për çdo 1.000 vajza të grupmoshës 15-19 vjeç nga 13,3 lindje që ishin në 2020.
- Norma e martesave të grave ndër vite tregon një rënie të martesave deri në moshën 24 vjeç dhe rritje të moshës mesatare në martesë të vajzave. Krahasuar me 5 vite më parë, gratë martohen relativisht rreth 0,7 vite më të mëdha.

Shëndeti:

- Raporti i abortit është përmirësuar krahasuar me vitet e fundit. Për vitin 2021 shënohen 164 aborte për çdo 1.000 lindje.
- Për moshat teke 15 deri në 19 vjeç, për çdo 1.000 lindje raporti i abortit rezulton më i lartë në moshën 18 vjeçare, 140 aborte për 1.000 lindje të gjalla.

Krimet dhe drejtësia penale:

- Nga 61 vrasje të regjistruara në vitin 2021, 26,2 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare. 62,5 % e viktimave nga vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare janë gra.
- Gratë e burgosura për Vrasje dhe Mashtrim zënë përqindjen më të lartë të grave të burgosura, përkatësisht 22,2 % dhe 20,6 %.

Për publikim: 06/07/2022

- Gratë e burgosura përbëjnë 1,3 % të të burgosurve gjithsej në vitin 2021, shumica e tyre janë me arsim 9 vjeçar dhe i përkasin grupmoshës 30-39 vjeç.


Tregues social nga Anketat në Familje:

- Përfitues të moshuar në qendrat sociale për vitin 2021 janë 55,4 % burra dhe 44,6 % gra.
- Gratë, gjatë vitit 2021 kanë kryer më shumë blerje online për veshje/pajisje sportive në krahasim me burrat (59,1 % për gratë dhe 40,9 % për burrat).

Gratë në vendimmarrje:

- Në strukturën e policisë, numri i punonjëseve gra rritet me uljen e nivelit të gradave. Për gradën Inspektor përqindja e grave është më e lartë (43,5 %).
- Në vitin 2021, shkalla e pjesëmarrjes së grave në parlament është 35,7 %. Përmirësimi i ndjeshëm i pjesëmarrjes së grave anëtare në Parlamentin e Shqipërisë u bë i mundur pas përfshirjes së kuotës 30 % në ndryshimet e kodit elektoral, në vitin 2008. Tendenca në rritje vihet re edhe në zgjedhjet parlamentare 2013, ku arriti në 18,0 %.
- Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në Tregti me 34,3 % dhe Shërbime të tjera me 40,1 %, për vitin.

Fig. 1 Pronare / administratore gra sipas aktivitetit ekonomik (%)



Burimi: Regjistri i ndërmarrjeve

Indeksi i pabarazisë gjinore (IPGJ):

- Indeksi i pabarazisë gjinore (IPGJ), në vitin 2021 rezulton 0,09 nga 0,06 që ishte në vitin 2020. Ndër vite, të gjithë treguesit e përdorur në llogaritjen e IPGJ, kanë patur përmirësime të lehta, përveç vdekshmërisë amtare, e cila me luhatjet e saj gjatë viteve, ka luajtur edhe rolin kryesor në luhatjen e këtij treguesi.